



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____2022

V E N D I M

Nr. 179, Datë 19.09.2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, mori në shqyrtim ankesën nr.111, datë 15.07.2022, e z. F.N., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes shoqërore*”² dhe “*për çdo shkak tjetër*” nga ana e Banka Credins, Dega Kombinat, Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesi Florant Brahim F.N. është dënuar me 2 (dy) vjet burg, me vendimin gjyqësor nr. 188, datë 28.01.2021, të Gjatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kryerjen e veprës penale të vjedhjes, duke shpërdoruar detyrën, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Kjo vepër penale është kryer gjatë periudhës kohore që ankuesi ka punuar në pozicionin e drejtuesit të filialit të Alpha Bank, Dega Kombinat. Pasi ka kryer dënimin, z. F.N. është liruar nga burgju në datën 21.09.2021 dhe ka filluar të ri integrohet në shoqëri, duke u punësuar pranë një subjekti privat.

Z. F.N. sqaron se në datën 23.06.2022, ai është paraqitur për të hapur një llogari page pranë Bankës Credins, Dega Kombinat, pasi punëdhënësi i tij e ka udhëzuar që këtë llogari ta hapte pranë kësaj banke. Punonjësja e Bankës Credins, Dega Kombinat ka ndjekur procedurat përkatëse dhe i ka kërkuar një dokument identifikimi dhe një dokument që provonte, se ai ishte i punësuar pranë subjektit përkatës, akte, të cilat i janë vënë menjëherë në dispozicion nga ankuesi. Pasi ka hyrë në sistemin e bankës për të regjistruar të dhënat e tij, punonjësja ka konstatuar se sistemi elektronik ka evidentuar se z. F.N. ka qenë dënuar paraprakisht me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe për

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Referuar vendimit nr. 188, datë 28.01.2021, të Gjatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

këtë arsye, sipas procedurës përkatëse duhej marrë një konfirmim nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave për hapjen e llogarisë së tij, të pagës. Ankuesi sqaron se punonjësja e Bankes Credins, Dega Kombinat e ka informuar për sa më sipër, duke i thënë se përgjigjen mbi hapjen e llogarisë do t'ia dërgonte në vijim.

Z. F.N. sqaron se në të njëjtën ditë ka kontaktuar nëpërmjet aplikacionit WhatsApp, në numrin e publikuar nga Banka Credins në faqen e saj zyrtare, nga ku i është komunikuar se duhet të kontaktojë me degën përkatëse të bankës, ku ka kërkuar hapjen e llogarisë së pagës. Menjëherë, ai ka kryer telefonatën drejt Degës Kombinat të Credins Bank, nga ku është njoftuar se ende nuk ishte marrë një përgjigje për rastin e tij. Në datën 29.06.2022, ankuesi shprehet se i është drejtuar Bankës Credins, Dega Kombinat, me e-mail në adresën zyrtare të punonjësës T.H. dhe ka marrë përgjigjen përkatëse me e-mail, se llogaria e pagës në emër të tij nuk mund të çelet, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave nuk e ka aprovuar një gjë të tillë. E-maili i dërguar nuk përmbante sqarime të tjera të mtejshme, mbi shkaqet që ndalonin hapjen e një llogarie page pranë kësaj banke.

Për sa më sipër, ankuesi F.N. pretendon se është diskriminuar nga ana e Bankës Credins për shkak të gjendjes së tij shoqërore, pasi i është refuzuar kërkesa për çelje të llogarisë së pagës, pasi ka qenë i dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

A. Pas analizimit fillestar, Komisioneri vlerësoi se ankesa nr.111, datë 15.07.2022, e z. F.N., duhet të plotësohej me informacion shtesë. Për këtë arsye, KMD iu drejtua ankuesit me shkresën nr. 1052/1, datë 25.07.2022, ku i kërkohej informacioni i mëposhtëm:

- 1. “Në kushtet kur, ju pretendoni se shkak i diskriminimit tuaj është “gjendja shoqërore” kuptohet se trajtimi i padrejtë dhe disfavorizues i pretenduar nga ana juaj, ka ardhur si pasojë e këtij shkak, pra mosofrimi i shërbimit të kërkuar nga ana e Credins Bank, Dega Kombinat, ka lidhje me gjendjen tuaj, shoqërore. Në këto kushte, lutemi të jepen shpjegime, se cila është gjendja juaj shoqërore dhe në ç’mënyrë ka ndikuar ajo në situatën e pretenduar si diskriminuese. Të depozitohen prova që vërtetojnë gjendjen tuaj shoqërore, ku të përfshihen vendim gjyqësor i formës së prerë, vërtetim vuajtje dënimi ose vërtetim lirimi nga IEVP Durrës etj.*
- 2. Si vërtetohet nga ana juaj që punonjësja e Credins Bank, Dega Kombinat ka patur dijeni mbi gjendjen tuaj shoqërore dhe si pasojë e saj nuk ju ka ofruar shërbimin e kërkuar?*
- 3. Informacion nëse në vijim keni kontaktuar zyrtarisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit e Pastrimit të Parave, për të marrë dijeni dhe për të konfirmuar faktin që nga ana e këtij institucioni, ju është ndaluar hapja e një llogarie bankare për pagën.*
- 4. Informacion mbi punëdhënësin tuaj (emër dhe adresë) dhe nëse ky punëdhënësi ka kryer përpjekje për t’ju asistuar për të hapur një llogari bankare, pranë Credins Bank, për të kaluar pagën tuaj.*
- 5. Te depozitohet në cilësi prove çdo e-mail i shkëmbyer me Credins Bank, Bankën e Shqipërisë dhe çdo institucion tjetër, mbi çështjen e parashtruar;*

6. Neni 1, i ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcakton një listë jo shtrruese shkaqesh diskriminimi. Ndër të tjera, ky nen ka parashikuar edhe opsionin “për çdo shkak tjetër”, duke i dhënë mundësinë ankuesit të përcaktojë një ose disa shkaqe të tjera, nga ato që parashikohen në listën e këtij neni. Në ankesën tuaj është shënuar se diskriminimi i pretenduar, përveç gjendjes shoqërore, mund të ketë ndodhur edhe “për çdo shkak tjetër”. Për sa më sipër, lutemi të jepet informacion nëse ekzistojnë shkaqe të tjera, për të cilat ju mendoni se jeni diskriminuar. Nëse ju përcaktoni shkaqe të tjera diskriminimi, lutemi që secili shkak të vërtetohet me fakte dhe prova konkrete nga ana juaj;”

-Në përgjigje të shkresës së sipërcituar së KMD-së, z. F.N. dërgoi shkresën nr. 1131 prot., datë 08.09.2022, nëpërmjet së cilës sqaron si më poshtë vijon:

“Më datë 28.01.2021, unë z. Florant Brahim F.N. jam dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me 2 vjet burg, për veprën penale “vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën”. Bashkëngjitur kësaj shkrese do gjeni kopje të vendimit të formës së prerë (pasi Apeli nuk e pranoi kërkesën time). Më datë 12.09.2021 jam liruar nga IEVP Durrës, pasi kam përfunduar dënimin sipas ligjeve në fuqi. Veprën penale e kam kryer në kohën që kam qenë drejtues i filialit të Alpha Bank në Kombinat. Historia ime me Bankën Credins fillon më datë 23.06.2022, kur unë paraqitem për të hapur një llogari page, pasi punëdhënësi më udhëzoi të hapja llogarinë pranë kësaj banke. Punonjësja më kërkoi një dokument identifikimi dhe dokument që vërtetonte se isha punonjës i subjektit që më kalonte pagën, të cilat ia vura në dispozicion. Pasi qendrova në bankë pranë punonjësës që po regjistronte të dhënat e mia, sipas saj sistemi i bankës nxorri një indicie për mua si person problematik dhe sipas procedurës duhet të merrte një konfirmim nga AML (departamenti i pastrimit të parave). Gjithashtu punonjësja me komunikoi se mund të largohesha pasi përgjigja mund të vonohej. Sapo ta kishte përgjigjen do të më telefononte. Pas disa orësh unë kontaktoj me nr e WhatsApp xxxxxxxxx, që Banka Credins ka në faqen e saj zyrtare dhe përdoruesi më drejtoi tek kontaktet e degës (bashkëngjitur komunikimi në WhatsApp me nr e Credins). Menjëherë kreu telefonatën drejt degës Kombinat dhe m'u komunikua që akoma s'kishin marrë përgjigje. Pasi kaluan disa ditë, më datë 29.06.2022 u drejtova me një email për t'u informuar dhe punonjësja më ktheu përgjigje se AML nuk e ka aprovuar hapjen e llogarisë së pagës dhe nuk mund të procedohej më tej (bashkëngjitur komunikimi me e-mail). I ndodhur në këtë situatë u jam drejtuar një sërë institucionesh si: Banka e Shqipërisë, Agjensia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Bashkisë Tiranë, por që nuk më dhanë zgjidhje. Banka Credins nuk më dha përgjigje tjetër se pse nuk ma hap llogarinë dhe unë nuk kam kohë të merrem ne shkresa të kota drejtuar kësaj banke pasi jam edhe i ngarkuar me punë dhe projekte të tjera personale dhe familjare. Ajo më komunikoi vetë se kishte një indicie nga sistemi. Gjithashtu rasti im u bë shumë mediatik në kohën kur ndodhi ngjarja pasi u sponsorizua nga individë të veçantë drejtues tek Alpha Bank, por ky fakt nuk është objekt i kësaj ankese. Të vetmet kontakte që kam bërë janë Dega Kombinat (me telefon në nr xxxxxxxxx dhe me e-mail t...h...@bankacredins.com) Në faqen zyrtare web të kësaj banke nuk ka numra të tjerë kontakti dhe nuk kam marrë ndonjë nismë për të dërguar shkresë zyrtare. Me thënë të drejtën e kam pasur shumë të vështirë pas asaj që më ndodhi të ri integrohem në jetën time shoqërore dhe

shumë të vështirë për të gjetur punë, kështu që mendova që mos ta bezdis punëdhënësin tim për këtë situatë se mund të më sillte pasoja të tjera që unë nuk i dëshiroj. Me pak fjalë mund të humb dhe punën për arsye të njëjtë me moshapjen e llogarisë. Bashkëngjitur kësaj shkrese do të gjeni emailt e shkëmbyera dhe mesazhet në WhatsApp. Nuk mendoj të ketë ndonjë shkak tjetër në lidhje me këtë ngjarje. Unë nuk disponoj informacion tjetër në lidhje me këtë rast.”

- B.** Në vijim, pas dërgimit të informacionit plotësues nga ankuesi F.N., si dhe pas analizimit në tërësi të ankesës nr.111, datë 15.07.2022, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- C.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bankës Credins, Dega Kombinat, si dhe për dijeni ankuesit, Bankës së Shqipërisë, Bankës Credins, Selia Qëndrore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, me shkresën nr. 1052/2 Prot., datë 09.08.2022, ku kërkohej informacioni i mëposhtëm:
1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit F.N.;
 2. Informacion mbi rastet kur Banka Credins vendos t’iu refuzojë shtetasve shqiptarë çeljen e llogarisë së pagës, apo edhe llogarive të tjera.
 3. Informacion mbi procedurat që ndiqen nga Banka Credins në rastet, kur persona që kanë qenë të dënuar më parë, kërkojnë çeljen e llogarisë së pagës apo llogarive të tjera pranë saj. Të depozitohet në cilësi prove akti rregullator i Bankës Credins, ku parashikohen rastet kur vendoset refuzimi dhe procedurat përkatëse, që duhen ndjekur nga banka;
 4. Informacion mbi numrin e individëve, që të kaluarën kanë qenë të dënuar dhe iu është refuzuar çelja e llogarisë së pagës apo ndonjë llogarie tjetër pranë Bankës Credins. Të përcillen pranë KMD-së, praktikat përkatëse të refuzimit;
 5. Nëse arsyeja e refuzimit nuk ka qenë ajo që pretendohet nga ankuesi F.N., të përcillet informacioni i saktë mbi shkakun real të refuzimit të çeljes së llogarisë së pagës në emër të tij, pranë Bankës Credins, Dega Kombinat;
 6. Kopje e letërkëmbimit zyrtar me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, për rastin e z. F.N.;
 7. Kopje e korrespondencës me e-mail së Bankës Credins, Dega Kombinat me ankuesin F.N.;

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me regjistrimin e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve pune nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër.”

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të KMD-së, Credins Bank dërgoi shkresën nr. 61184/1 prot., datë 22.08.2022, nëpërmjet së cilës e informon KMD-në se:

“Banka Credins SHA, është një shoqëri e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, rregjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Nr. 28969, Dt. 31.01.2003, e regjistruar në organit tatimore dhe Kodin Fiskal Nr. 3709529 dhe NIPT K316088010.

Në përputhje me ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikat e Shqipërisë”, Banka Credins sh.a., është e pajisur e Licencë nr. 16, datë 31.03.2003, për të ushtruar veprimtarinë e përcaktuar në nenin 54 të këtij ligji.

Nëpërmjet shkresës Tuaj mr Nr. 1052/2 prot., datë 09.08.2022. “Njoftim dhe kërkesë për informacion”, drejtuar Bankës Credins sh.a., jemi informuar mbi ankesën drejtuar institucionit tuaj nga z. F.N..

Pasi u njohëm me pretendimin e z. F.N. dhe kërkimet tuaja në lidhje me këtë pretendim, në përgjigje të pikës 5 ju informojmë si më poshtë vijon.

Në zbatim të kërkesave rregullative, kushtet dhe procedura e vendosjes së marrëdhënies me klientët, rregullohet nga një sërë aktesh të brendshme rregullative, si politika, procedura, rregullore të miratuara në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe standardet më të mira bankare. Banka Credins në cilësinë e institucionit financiar gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj është përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit. Në kuadër të përmbushjes së detyrimit sa më sipër, sipas kërkesave të Ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave” vendosja e marrëdhënies me klientin bazohet në Procedurën “njihe klientin tënd” (KYC), e cila sipas ligjit të cituar përfshin një sërë rregullash që kanë të bëjnë me politikat e pranimit e të identifikimit të klientit dhe administrimit të riskut të tyre. Në kuadër të ushtrimit të vigjilencës, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, Banka duhet të marrë një sërë masash të cilat kanë si qëllim identifikimin dhe verifikimin e plotë dhe të saktë të klientëve, pronarit përfitues, natyrën dhe qëllimin e transaksionit apo marrëdhënies si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit dhe të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve, për të siguruar që janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut, duke përfshirë kur është e nevojshme edhe burimin e fondeve. Në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi, Banka për të gjithë individët dhe personat juridikë shqiptarë apo të huaj, zbaton procedurën e njohjes së klientit, e cila përvec verifikimit dhe identifikimit të klientit, përfshin edhe identifikimin e qëllimit të çeljes së llogarisë, produktit bankar dhe ndërtimin e një profili risku në bazë të të cilit zbatohen edhe masat e monitorimit të vazhdueshëm të klientit.

Vendosja e marrëdhënies me klientët kalon në disa hapa me qëllim arritjen e një vlerësimi tërësor dhe dinamik të klientit, duke u bazuar në faktorë si rreziku i klineit, rreziku gjeografik, rreziku i produktit, shërbimeve etj. Procesi vendimmarrës shoqërohet me kërkesa për informacion dhe dokumentacion justifikues shtesë në raste kur konstatohen tipologji të caktuara të vlerësuara nga praktikat më të mira ndërkombëtare, ndër të tjera edhe në guidat, udhëzuesit e FATF-ës (Financial Action Task Force). Disa nga elementët e dyshimtë që mund të lidhen me klientët individë janë mosdhënia e informacionit të kërkuar nga punonjësi i bankës apo nëse informacioni i dhënë

ndryshon pa ndonjë justifikim të qartë, sjellje anormale nervoziteti nga klienti gjatë kryerjes së transaksionit; transaksioni i kërkuar nuk përputhet me profilin e klientit, aktiviteti, veprimtaria nga e cila sigurohen fondet vlerësohet me risk për tipologjinë e klientit etj. Banka refuzon vendosjen e marrëdhënies me klientët potencial vetëm në rastet kur nga vlerësimi në tërësi i faktorëve të rrezikur, tipologjive të konstatuara gjatë procesit të vendosjes së marrëdhënies nuk përmbushen kërkesat për informacion/dokumentacion për ushtrimin e vigjilencës së duhur apo të zgjeruar dhe/ose kërkesa e klientit është jashtë oreksit të bankës për risk, e cila bazohet në standardin themelor që udhëheq politikën e parandalimit të pastrimit të parave, që është qasja e bazuar në risk. Dënimi penal në vetëvete nuk është kriter që çon automatikisht në refuzimin e vendosjes apo ndërprerjen e marrëdhënies me klientin. Duke mos qenë kriter për vendosjen/ndërprerjen e marrëdhënies, banka nuk ka një statistikë apo databazë klientësh të refuzuar për këtë arsye. Duke mos qenë kriter për vendosjen/ndërprerjen e marrëdhënies, Banka nuk ka statistikë apo databazë klientësh të refuzuar për këtë arsye. Shërbimi për z. F.N. nuk është refuzuar për shkak të dënimit penal që ai ka vuajtur/shlyer por ka ardhur si rrjedhojë e indikatorëve të konstatuar gjatë procedurës së vendosjes së marrëdhënies, përkatësisht mungesa e bashkëpunimit në vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar dhe deklaratimet kontradiktore të bëra prej tij në degë.

Gjatë intervistës me klientin, nga punonjësi i bankës në degën Kombinat, degë në të cilën klienti është paraqitur për vendosjen e marrëdhënies, është kërkuar depozitimi i kontratës së punës, si dokumenti bazë në të cilin vlerësohen elemente të rëndësishme të marrëdhënies së punës, si paga, kohëzgjatja e marrëdhënies etj., të cilat do të ndihmonin bankën në ndërtimin dhe vlerësimin e riskut të klientit e për rrjedhojë edhe planin e monitorimit. Me gjithë kërkesat dhe përpjekjet e punonjësit në degë nga aplikanti për klient është depozituar vetëm Deklarata e të Punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna, e datës 22.06.2022, e subjektit tatimpagues L.R., person fizik, me NUIS XXXX. Gjatë intervistës, klienti nuk ka qenë koherent mbi deklaratimet e bëra për rezidencën aktuale, kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës dhe natyrën e pagesave që herë i ka cilësuar si pagesa të prapambetura dhe herë të tjera si pagë nga marrëdhënia e punësimit. Në këto kushte, refuzimi i dhënies së shërbimit, nuk është rrjedhojë e analizës së vlerësimit të gjendjes shoqërore (ndonëse në vlerësimin tonë, të qënurit i dënuar i referohet gjendjes gjyqësore dhe jo asaj shoqërore) të z. F.N., por e zbatimit të detyrimeve ligjore, që Banka Credins zbaton gjatë veprimtarisë së saj tregtare.”

- Në kushtet kur, zarfi me shkresën nr.1052/2 Prot., datë 09.08.2022, të KMD-së drejtuar për dijeni ankuesit, ishte kthyer mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin “adresë e pamjaftueshme”, si dhe në kushtet kur z. F.N. nuk pati asnjë reagim ndaj informacionit të Bankës Credins, KMD u mundua të kontaktonte ankuesin nëpërmjet numrit të celularit të shënuar në formularin e ankesës së tij, por përpjekjet rezultuan të pasuksesshme.
- Në vijim, KMD iu drejtua ankuesit F.N. nëpërmjet e-mailit të datës 06.09.2022, ku i kërkon që paraqitet për të tërhequr dorazi shkresën nr.1052/2 Prot., datë 09.08.2022 e KMD-së, për të parashtruar kundërshtimet e tij ndaj informacionit të dërguar nga Banka Credins, si dhe

për të depozituar në cilësi prove kopje të librezës së tij të punës dhe kontratës individuale të punës.

- Në përgjigje të e-mailit të KMD-së, ankuesi F.N. përgjigjet me e-mail në të njëjtën datë, ku informon se është larguar nga Shqipëria dhe kërkon në rrugë elektronike një kopje të shkresave të sipërcituara.
- KMD i dërgoi me e-mail shkresat e sipërcituara dhe theksoi sërish faktin se për efekt të hetimit administrativ, kërkon të administrojë një kopje të librezës dhe kontratës së tij të punës, si dhe një adresë e saktë banimi, ku korrespondenca zyrtare e KMD-se të jetë e aksesueshme nga ana e tij.
- Gjatë korrespondencës me e-mailet vijuese me KMD-në, ankuesi deklaroi se: *“Lexova shkresën e Credinsit dhe dua të sqaroj se të dhënat e mia ata i kanë pasur pasi kam qenë i regjistruar më parë në atë bankë. I thashë punonjësës që asgjë nuk ka ndryshuar përveç se nr. të telefonit që ia vura në dispozicion, gjë që mund të vërtetohet nga raporti i ndryshimeve të të dhënave të regjistrimit që ka çdo bankë. Gjithashtu dua të theksoj se komunikimi mes meje dhe punonjësës ishte shumë miqësor.”* Ankuesi deklaroi gjithashtu se është duke kërkuar azil në një shtet tjetër dhe aktualisht nuk ka një adresë të saktë banimi. Ai u shpreh gjithashtu se është tepër i ngarkuar për të sistemuar jetën e familjes së tij në një vend të huaj dhe se në këto kushte nuk mund të jetë i disponueshëm dhe aktiv përgjatë hetimit të KMD-së, si dhe kërkoi tërheqjen e tij nga ankesa.

Mbështetur në sa më sipër, KMD çmon se:

Mbështetur në nenin 90 *“Përfundimi i procedurës administrative”*, paragrafi 3, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ.”*

Bazuar në nenin 94 *“Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”*, paragrafi 1, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”*

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga ankuesi F.N., i cili është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës

duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 3, nenin 33 pika 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenin 90, pika 3 dhe 94, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.111, datë 15.07.2022, së z. F.N., pa një vendim përfundimtar, pasi ankuesi është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha – Shërbime

Shkak – gjendja shoqërore, çdo shkak tjetër

Lloji i vendimit – tërheqje e ankesës